

VENDIM
Nr.3, datë 6.1.2011

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË
KRYERA NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E NJËSITË E PUSHTETIT
VENDOR, SI AUTORITETE KONTRAKTORE, PËR PUNIMET E PROJEKTEVE TË REJA NË
ARSIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njësive të qeverisjes vendore, të cilave, me vendimin nr.3, datë 2.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpërndarjen e fondeve të zhvillimit të rajoneve”, u është miratuar financimi i objekteve në arsim, për:

a) projektin “Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Faik Trungu”, Zgosht, komuna Lunik, Librazhd;

b) ndërtimin e shkollës 9-vjeçare dhe të kopshtit, Vukatanë, komuna Guri i Zi, Shkodër;

c) shtesën anësore, përfundimin e punimeve dhe sistemimin e oborrit të shkollës 9 - vjeçare, Topojë, komuna Topojë, Fier, dhe që kanë filluar procedurat e prokurimit për këto objekte, gjatë vitit 2010, u lejohet përfundimi i procedurës së prokurimit edhe pas datës 31 dhjetor 2010. Këtu përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës e institucionet në varësi të saj, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha